



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ÇËRRIK

Cerrik me, 12.09.2023

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** *“Permiresim i banesave ekzistuese per komunitete te varfra dhe te pafavorizuara”*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Punime ndërtimi për shtëpi 45211100-0

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 38309100 ( *tridhjetë e tetë milion e treqind e nente mijë e njeqind*) Lek pa TVSH. Buxheti i shtetit + Buxheti i Bashkise sipas planifikimit buxhetor.

Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i bashkise referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015,(ndryshuar me VKM-në nr.631,datë 26.10.2018 ,si dhe ne aktin normativ nr.10 date 18.05.2022” Per kompesimin financiar te cmimit per disa materiale ndertimi sipas percaktimit te kontrates per pune publike si pasoje e situates se vecante te krijuar ne treg gjate vitit 2022” me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Cërrik ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Vertetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të matuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;*

b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizim të objektit të prokurimit dhe merr persiper çdo rrezik që mund të ndodhë sic parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën për një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” është përcaktuar si me poshte: *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.2 Per te vertetuar nje aktivitet ekonomik te qendrueshem, operatorët ekonomike duhet te paraqesin bilancet vjetore 2020, 2021, 2022 te shoqeruar me akt ekspertizen e ekspertit kontabel te autorizuar ku bilancet e dy viteve te njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Shëmin: *Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë*

dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë edhe duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 si dhe kestin për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2023, sipas përcaktimeve të ligjit referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

***Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, nenit 26 e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **1.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

### **2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

*a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit; **(ne rastet kur ky dokumentacion leshohet)**
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

**Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

*b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- Vertetim leshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtare
- Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokumentacion leshohet)**
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

**Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
  - a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
  - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

## **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punët të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.*

**2.3.3** Operatoret ekonomike duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do të behet mbi bazen e rregullave të parashikuara sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

### **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

- **NP-1 - B** (*Punime germimi ne toke*)
- **NP-2 - B** (*Ndertime civile dhe industriale*)
- **NP-3 - B** (*Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e speciale,veshje fasada*)
- **NP-7- B** (*Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje*)
- **NP-11 – B** (*Ndertime per N/Stacionet,kabinat e transformatoreve linja e TN e mesem dhe shperndarjen e energjise*)
- **NP-12- B** (*Punime te inxhinierise se mjedisit*)

### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

- **NS-1- B** (*Punime per prishjen e ndertimeve*)
- **NS-2 – B** (*Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavaxteri, mirembajtja e tyre*)
- **NS- 4 B –** (*Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese*)
- **NS-12–B** (*Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit*)
- **NS- 13- A** (*Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni*)
- **NS-14- B** (*Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj*)

- **NS- 18 –B** (*Punime topogjeodezike*)
- **NS 19 – A** (*Sistemet kundra zhurmes per infrastrukture*)

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përlogaritur të kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<b>NP-1 - B</b>	<i>(Punime germimi ne toke)</i>	Germim dheu themel, hedhje , rafshim mbushje dheu me krah kategoria III etj,	B	21- 50 milion lekë
<b>NP-2 - B</b>	<i>(Ndertime civile dhe industriale)</i>	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve	B	21- 50 milion lekë

		të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Kemi te bejme me rikonstruksionin e 48 banesave .		
<b>NP-3 - B</b>	<i>(Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e speciale,veshje fasada</i>	Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje	B	21-50 milion leke
<b>NP-7- B</b>	<i>(Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje)</i>	Percaktohen zera ne preventiv ne sesionin punime per shkarkimin e ujrave si: vendosje tuba PPD 110 mm, Tub PD 50mm , Berryla PD 50mm-90o etj .	B	21- 50 milion lekë
<b>NP-11 – B</b>	<i>(Ndertime per N/Stacionet,kabinat e transformatoreve linja e TN e mesem dhe shperndarjen e energjise)</i>	Konsiderohen ndertime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.	B	21- 50 milion lekë
<b>NP-12- B</b>	<i>(Punime te inxhinierise se mjedisit)</i>	Per shkak te rikonstruksionit te 48	B	21- 50 milion lekë



		shtepive do te dalin mbetje te shumta inerte.		
<b>NS-1- B</b>	<i>(Punime per prishjen e ndertimeve)</i>	Percaktohen zerat ne preventiv si : prishje catie vendi, prishje mur prej guri ne katin e pare , prishje mur guri per vendosjen e plintave dhe kollonave etj,	B	21- 50 milion lekë
<b>NS-2 – B</b>	<i>(Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)</i>	Percaktohen punime per vendosje pajisje hidrosanitare ne preventiv si : F.V lavaman porcelani me kollone +grupi, F.V WC alla frenga porcelani, F.V lavapjate importi me llamarine xingat, F,V bolier 100 liter importi etj.	B	21- 50 milion lekë
<b>NS- 4 B –</b>	<i>(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)</i>	Percaktohen punime te rifinitures dhe muratures ne preventiv si: patinim tavan allci, suva brenda mur tulle h-4 m jasht, llaci perzier M25, lyerje me boje hidroplastike brenda e jashte , Suva kornize b.a h-4 m jashte, suvatim muri fasade etj.	B	21- 50 milion lekë
<b>NS-12–B</b>	<i>(Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit)</i>	Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me	B	21- 50 milion lekë

		punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi		
<b>NS- 13- A</b>	<i>(Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)</i>	konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.	A	0-20 milion leke
<b>NS-14- B</b>	<i>(Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)</i>	Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.	B	21- 50 milion lekë
<b>NS- 18 –B</b>	<i>(Punime topogjeodezike)</i>	Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime	B	21- 50 milion lekë

		topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh		
<b>NS 19 – A</b>	<i>(Sistemet kundra zhurmes per infrastrukture)</i>	Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve. Percaktohen zera : dritare d/alumini dyfish xham , fv dyer te brendshme me tamburate te rime, Fv dyer te brendshme druri importi cilesi e mire etj.	A	0- 20 milion leke

2.3.4 Operatorët ekonomike pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punetore minimalisht 100 **(njqind) personash**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **Maj 2023- Korrik 2023**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi

*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

*Argumentimi:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Argumentim:* Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje , tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Jane përcaktuar 100 punonjes per shkak se jane 48 banesa per tu rikonstruktuar brenda nje kohe te shkurter prej 30 ditesh dhe duhet te perfundojne para se te fillojne shirat dhe ngricat.*

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqesë, Kontrate pune e vlefshme, diplome , libeze pune dhe CV.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

1 inxhinier ndertimi- Kerkohet Inxhinieri ndertimi pasi kemi te bejme me rikonstrukcion te 48 objekteve. Referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime ndertimi te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri i ndertimit gjate gjithe periudhes te zbatimit te punimeve.

1 inxhinier mjedisi – Kerkohet inxhinier mjedisi pasi kemi te bejme me punime germimi, ndertimi, heqje dherash etj, qe kane ndikim negativ ne mjedisin perreth. Gjate zbatimit te projektit, eshte e pashmangshme qe ne realizimin e punimeve te kete mbeturina e inerte te cilat jane te nje rrezikshmerie te larte per komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet te realizohet ne perpikmeri dhe ne kohe reale, prandaj asistenca e nje inxhinieri mjedisi do te jete e domosdoshme.

1 inxhinier elektrik- kerkohet inxhinieri elektrik per shkak se do te kete punime ne 48 banesa punime te cilat do te prishin rrjetin elektrik dhe asistenca e nje inxhinieri elektrik eshte e domosdoshme per ecurine e punes.

1 inxhinier hidroteknik- kerkohet inxhinieri hidroteknik pasi kemi te bejme me punime furniziim me uje dhe punime per shkarkimin e ujrave te cilat kane nevojte per asistencen e nje inxhinieri hidroteknik.

1 inxhinier mekanik- Kerkohet inxhinieri mekanik, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime te strukturave metalike neper strehat e objektit. E kemi kerkuar kete inxhinier per arsye se mund te kete problematika gjate zbatimit te punimeve dhe mund te kete ndryshime dhe rregullime te cilave mund ti pergjigjet gjate zbatimit inxhinieri perkates. Si dhe eshte e domosdoshme asistenca e inxhinierit per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren gjate zbatimit te punimeve.

1 inxhinier gjeodet/ topograf- kerkohet inxhinieri topograf per te mbikqyrrur relivein dhe zonat ne te cilat jane shtepite per te kontrolluar qendrushmerine e vendit ku do te jene banesat.

2.3.6 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , librezë pune dhe CV.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

### **2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjesit specialistë të kualifikuar ne profilet perkatese si më poshtë:**

- Teknik Ndertimi 1 (nje)
- Teknik Topograf 1 (nje)
- Elektracist 2 (dy)
- Hidraulik 2 (dy)
- Karpentiere 2(dy)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Mekanik 1 (nje)
- Murator 3 (tre)
- Pllakashtrues 3(tre)
- Hidroizolues 1 (nje)
- Bojaxhi 3 (tre)
- Punetor/Specialist ndertimi 1 (nje)
- Manovrator 2 (dy)
- Shofer 2 ( dy)
- Punonjës/specialist duralumini 1(nje)
- Punonjës/specialist sistem ngrohje 2 (dy)

#### **Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:**

Kontratet e punës individuale (të vlefshme).

Certifikata ose deshmi perkatese

Si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per periudhen Maj-Korrik.

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Teknik ndertimi jane te domosdoshem per shkak te punimeve te ndertimit qe do te kryhen ne 48 banesat.

Teknik topograf eshte i domosdoshem per shkak te relievit te disa banesave.

Elektricitet- është i nevojshëm për shkak të punimeve të prishjes e do të kryhen të cilat mund të prishin instalimet elektrike dhe duhet të kryejnë rregullimet e nevojshme.

Hidraulik- janë të nevojshëm për shkak se do të kryhen instalimet e tubave dhe, vendosjen e lavamanëve, vendosje lavaman porcelani etj.

Karpiçer- është i nevojshëm për shkak se do të kryhen punimet e betonit, vendosja e armatues etj.

Hekurthyes- është i nevojshëm për kthimin e hekurit në ndërtimin e mureve, përcaktohen vëllime konkrete punë zero si: FV hekuri betoni periodik 6-10mm , fv hekuri betoni periodik etj,

Muror- është i nevojshëm për shkak të punimeve të shtatimeve, që do të kryhen në të gjitha banesat e përkatesisht në zero , suva brenda mur tulle, llac i perizer, suva xokoli me grani e cimento , etj,

Pllakashtues – përcaktohen punime të vendosjes së pllakave e përkatesisht në zero si : shtresë me pllaka gres porcelante objekti 32 i preventivit etj.

Hidroizolues- është i nevojshëm për shkak të punimeve të hidroizolimit në preventivin fillestar e përkatesisht në zero: h/izolim tarace 2cm etj.

Bojaxhi- janë të domosdoshëm për shkak se do të kryhen llyerjet e gjithë banesave të cilat janë për rikonstrukcion.

Punëtor/ specialist ndërtimi- përcaktohen punime në preventivin fillestar si breza e trare, cati vendi e zakonshëm, tavan kartonxhez, prishje cati vendi, trotuar me lluster cimento pa bordurën e betonit me gjerësi 60 etj.

- Manovrator 2 (dy)- janë të domosdoshëm për drejtimin e mjeteve të cilat do të përdoren për punimet që do të kryhen

- Shofer 2 ( dy)- janë të domosdoshëm për drejtimin e mjeteve të cilat do të përdoren në punimet që do të kryhen .

- Punonjës/specialist duralumini 1(një)- përcaktohen vëllime konkrete punë preventivin fillestar të cilat do të realizohen nga punonjësi i duralumini e përkatesisht zero si : dritare d/alumini dopio xham banesa 19, Fv dritare të brendshme druri importi cilësi e parë, dritare d/alumini dopio xham etj.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, e dhënë nga një organizim i licencuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën Maj 2023- Korrik 2023.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizim i licencuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën Maj 2023- Korrik 2023.

- Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar

**një mjek** të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse ,si dhe faturen e këtij shërbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).

Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj 2023- Korrik 2023.

***Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. AK argumenton se kërkesa për 1 (nje) *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

*Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilët janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidentet me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjësi të pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.*

*Kriteri për mjekun është vendosur në përputhje me ligjin Nr.10 237, datë 18.2.2010 “ PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË”, i ndryshuar e specifikisht nënenin 23 i cili parashikon*



se : Neni 23 Shërbimi mjekësor i punës 1. Çdo punëdhënës i një subjektipublik apo privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës. 2. Kontrolli i shëndetit, në varësi të numrit të punëmarrësve dhe të natyrës së punës, është i organizuar në: a) shërbim mjekësor në punë, I vlefshëm për degët/filialet në varësi; b) shërbim mjekësor në punë, ndërsbjektor. 15 3. Mënyra e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë, përfshirë normat, rregullat dhe procedurat për të siguruarkontrollin mjekësor të pranimit në punë dhe ato periodike për punëmarrësin, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

**2.3.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri n 3 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Kamion me Vinc	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Trajler per transport mjetetsh	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Rimorkio për transport mjetesh	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Fadrome me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Eskavator me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Minieskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Mini fadrome bobcat	në pronësi ose me qira	Cope 1
13	Autobeniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Pompa Suvatimi	në pronësi ose me qira	Copë 3

17	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Skeleri	në pronësi ose me qira	Min 500 m2
19	Vinç kullë me krah jo me pak se 30 meter	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Greider	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Aparat topogjeodezik me GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
22	Depozite uji 1000l-5000l	në pronësi ose me qira	Copë 5
23	Pompa Uji	në pronësi ose me qira	Copë 3
24	Rul vibrues minimumi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
25	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë 1
26	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2
27	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
28	Fabrikë prodhimi bordura dhe pllaka betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
29	Fabrike Prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatë transporti, fotot përkatëse ku të duket qarte targa;
- Nëse për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot ku të duket qarte dhe shërbimi i tij, nëse për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe e makinerive/pajisjeve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

## **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.3.9 Kërkesa të veçanta për kualifikim**

*Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (oseekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë :*

<i>ISO 9001:2015</i>	<i>Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë</i>
<i>ISO 14001:2015</i>	<i>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor</i>
<i>ISO 45001-2018</i>	<i>Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë</i>

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zerave të punimeve që do të realizojë.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë, bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale; Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore, mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

*Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:*

Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre, për përmbushjen me sukses të kontratës.

Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësi të cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë sipas shënimeve në projektet perkatese, bashkelidhur dokumenteve të tenderit, të hartuara nga projektuesit.*

NJESIA E PROKURIMIT

---

---

---